

Në bazë të Marrëveshjes për bashkëpunim në mes Agjencisë për punësime të RM-së (APRM), Programit për zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe Qytetit të Shkupit, Planit operativ për programet dhe masat aktive për punësime dhe shërbime të tregut të punës për vitin 2018, të miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, Programit për angazhime në punët e dobishme – komunale, të financuar nga Buxheti i Agjencisë për punësime të RM-së, më datën 01.08.2018 shpallet:

**KONKURS PUBLIK**  
**Për personat e evidentuar si të papunësuar për kyçje në**  
**Programin për angazhime në punët e dobishme komunale**

Ftohen të gjithë personat e evidentuar si të papunësuar, të cilët shprehin interesim që të kyçen në Programin për angazhime në punët e dobishme komunale, projekti “Përfitimet socio – arsimore përmes përkrahjes së kategorive të cenuara të qytetarëve në territorin e Qytetit të Shkupi”, për angazhim pune me orar të shkurtuar pune për periudhën prej 9 (nëntë) muajve me qëllim të përfitimit të aftësive dhe kyçjes së tyre graduale në tregun e punës, të paraqiten në Agjencinë për punësime – Qendra për punësime e qytetit të Shkupit.

Personat e evidentuar si të papunësuar, të cilët do të kyçen në Programin “Angazhime në punët e dobishme komunale”, do të angazhohen me punë me orar të shkurtër pune me 20 (njëzet) orë pune në javë, dhe gjatë angazhimit punues prej 9 (nëntë) muajve, statusi i personit të papunësuar u mbetet i pandryshuar, kurse personave të papunësuar – shfrytëzues të ndihmës sociale gjatë kohëzgjatjes së angazhimit punues do tu mbetet aktive e drejta e shfrytëzimit të ndihmës sociale.

Të drejtën për pjesëmarrje në Programin “Angazhime në punët e dobishme komunale”, e gëzojnë të gjithë personat e papunësuar, gjatë kësaj përparësi do të kenë personat të cilët për herë të parë paraqiten për pjesëmarrje në këtë Program.

Për kandidatët të cilët do të zgjidhen dhe kyçen në Programin “Angazhime në punët e dobishme komunale”, parashikohet kompensimi monetarë në lartësi prej 9.000 denarë në muaj, duke llogaritur tatimin personal të të ardhurave dhe sigurimin në raste të fatkeqësisë gjatë angazhimit punues dhe shfaqjes së sëmundjeve profesionale.

Personat e evidentuar si të papunësuar, të cilët do të paraqiten për pjesëmarrje në Programin “Angazhime në punët e dobishme komunale”, duhet ti përkasin njërit prej grupeve vijuese të synuara të personave të papunësuar:

- Persona të papunësuar një periudhë më të gjatë kohore (mbi 12 muaj në evidencën)
- Persona të rinj të moshës deri më 29 vjeçare
- Persona më të moshuar se 50 vite
- Persona shfrytëzues të ndihmës sociale ose të kompensimit monetarë në bazë të papunësisë
- Persona të cilët kanë pasur statutin e fëmijëve pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore
- Viktima të dhunës familjare
- Persona të gjinisë femërore, përkatës të bashkësive më të vogla etnike
- Persona përkatës të bashkësisë etnike rome
- Prindër të vetëm
- Prindër të fëmijëve të cilët ballafaqohen me pengesa gjatë zhvillimit
- Prindër të 3 dhe më shumë fëmijëve



Pozitat punuese të përfshira me këtë konkurs, kanë të bëjnë me angazhimin e:

- 10 Asistent arsimorë
- 5 Përkujdesës të personave të moshuar
- 5 Asistent personal

Personat e papunësuar që shprehin interesim, Fletëparaqitjet për pjesëmarrje në Programin “Angazhime në punët e dobishme komunale”, mund ti parashtrojnë në Agjencinë për punësime – Qendra për punësime e qytetit të Shkupit, në periudhën nga 01.08.2018 deri më 14.08.2018, nga ora 08:00 deri në ora 14:00 .

Kushtet më konkrete, të drejtat dhe obligimet do të rregullohen me lidhjen e Kontratës në mes Qytetit të Shkupit dhe kandidatët e përzgjedhur.

Informacione më të detajuara në lidhje me Programin “Angazhime në punët e dobishme komunale”, mund të fitohen te personi Radica Todorovska, Koordinator komunal për Programin “Angazhime në punët e dobishme komunale”, Agjencia për punësime – Qendra për punësime e qytetit të Shkupit, te personi Florie Laçi, Qendra për punë sociale e qytetit të Shkupit, te personi Sonja Arsovska.